



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 89-të, të mbajtur më 20.07.2023, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Denoncimi me numër 12-1994/1 të datës 21.05.2021 me pretendimet për auditim të kryer në mënyrë të parregullt në një konvikt studentor "-----", Shkup, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprim kompetent në lidhje me kërkesën e parashtruesit për faktin se Komisioni nuk ka kompetencë për ti vlerësuar raportet e ESHR-së dhe për të analizuar/vlerësuar funksionimin e ESHR-së, dhe sipas pretendimeve të tjera, KSHPK-ja është duke vepruar sipas lëndës së formuar për të cilin procedura është në vazhdim e sipër, nuk është marrë asnjë vendim në kompetencë të KSHPK-së.

Lënda me numër 12-1994/1 të datës 21.05.2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së në formë të depersonalizuar të publikohet në faqen e internetit të KSHPK-së- brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

### Arsyetim

Më datë 21.05.2021, një parashtrues i njohur, -----, ka dorëzuar denoncim të regjistruar me numër 12-1994/1 datë 21.05.2021, për auditim të papërshtatshëm të kryer nga Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) institucionit shtetëror Konvikti Shtetëror i Studentëve "-----". Shkup, me raporte të publikuara më 12 maj 2021 në ueb faqen e ESHR-së, të cilat janë bashkangjitur. Parashtruesi beson se raportet e përmendura lejojnë mbulimin e krimeve nga drejtuesit e konviktit studentor, si dhe përfshirjen e disa ish-ministrave të përmendur në ankesën e tij të paraqitur në ESHR, ku ai kundërshton mospërputhjet dhe mbulimin nga ana e tyre.

Raportit i bashkëlidhet një urgjencë e paraqitur me numër 12-1994/2 datë 02.06.2021, e cila i referohet raportit të parashtruesit të dorëzuar në KSHPK më 28.05.2020, me pretendimet për keqpërdorim të dyshuar të pozitës dhe autoritetit zyrtar të drejtorit të konviktit "-----", personi ----- i cili me falsifikimin e një dokumenti - certifikate ndërkombëtare të njohjes se gjuhës angleze ka bërë të mundur marrjen e pozicionit të tij në mënyrë të paligjshme.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës në fjalë, KSHPK-ja thekson se:

- nuk ka kompetencë të veprojë sipas kërkesës së parashtruesit për të vlerësuar Raportet e ESHR-së dhe për të analizuar/vlerësuar funksionimin e ESHR-së;

- në lidhje me dyshimet për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autoritetit të drejtorit të konviktit studentor "-----", personi ----- i cili duke falsifikuar nje dokument - certifikate ndërkombëtare te njohjes se gjuhës angleze ka bere te mundur marrjen e pozicionit te tij. në mënyrë të kundërligjshme, të cilat janë futur në kërkesën e parashtruesit është dorëzuar në KSHPK më 28.05.2020, në KSHPK është formuar lënda numër 12-2059/1 e datës 28.05.2020, pas së cilës janë ndërmarrë veprime për konstatimin e gjendjes faktike. Informacioni për veprimet kompetente është kërkuar nga organet tjera kompetente pranë të cilave zhvillohet procedura për rastin në fjalë.

Duke marrë parasysh konstatimet e mësipërme, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprimin e saj kompetent në rastin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHETËTOR  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**

**Kryetar,  
Biljana Ivanovska**

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: J.C,

Miratoi: G.T, anëtar i KSHPK-së